# FLETORJA ZYRTARE
# E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

**Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare**
**www.legjislacionishqiptar.gov.al**
**www.qpz.gov.al**

| **Nr.203** | **dhjetor** | **2008** |
|---|---|---|


## P Ë R M B A J T J A


| | | Faqe |
|---|---|---|
| Vendim i KM nr.1646, datë 24.12.2008 | Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zgjerimi i varrezave në komunën Xhafzotaj, Durrës…………………………………………… | 10953 |
| Vendim i KM nr.1649, datë 24.12.2008 | Për shtyrjen e afatit të botimit të njoftimit të fituesit dhe njoftimit të kontratës së lidhur, për procedurat e prokurimit, të kryera nga Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës-Kanalizimeve, bashki, komuna e këshilli i qarkut të Dibrës, si autoritete kontraktuese…………………. | 10954 |
| Vendim i KM nr.1650, datë 24.12.2008 | Për shtyrjen e afatit të botimit të njoftimit të fituesit dhe njoftimit të kontratës së lidhur, për tri procedura prokurimi, të kryera nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, si autoritet kontraktues………… | 10955 |
| Vendim i KM nr.1655, datë 24.12.2008 | Për shpërblimin e pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të zëna nga ndërtimet informale, dhe për sipërfaqet takuese… | 10956 |
| Vendim i KM nr.1656, datë 24.12.2008 | Për miratimin e fondit për likuidimin e pagesave të prapambetura për punonjësit e ndërmarrjes shtetërore, ish-Kombinati i Tekstileve, Tiranë………………………………………………………………… | 10960 |
| Vendim i KM nr.1658, datë 24.12.2008 | Për disa ndryshime e shtesa në vendimin nr.306, datë 27.6.2002 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të punonjësve me arsim të lartë në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Spitalin Ushtarak Qendror Universitar, në sistemin e Ministrisë së Mbrojtjes", të ndryshuar…………………………………. | 10962 |
| Vendim i KM nr.1659, datë 24.12.2008 | Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i rrugës Kardhiq-Delvinë………………………………………………………………… | 10966 |

| | | |
|---|---|---|
| Vendim i KM nr.1662, datë 24.12.2008 | Për një ndryshim në vendimin nr.1586, datë 3.12.2008 të Këshillit të Ministrave "Për transferim fondesh nga buxheti i vitit 2008, për Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës"………………..… | 10971 |
| Vendim i KM nr.1670, datë 24.12.2008 | Për një ndryshim në vendimin nr.638, datë 18.9.2003 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave të punonjësve të infermieristikës, në sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë", të ndryshuar…………………………………………… | 10971 |
| Vendim i KM nr.1671, datë 24.12.2008 | Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Rrëshen-Kalimash………………………………………………… | 10975 |
| Vendim i KM nr.1673, datë 24.12.2008 | Për caktimin e rregullave për shitjen e pasurive të personave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë ………………… | 10976 |
| Vendim i KM nr.1675, datë 24.12.2008 | Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.84, datë 3.2.2008 të Këshillit të Ministrave "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Kalimash-Morinë"……………………… | 10979 |
| Vendim i KM nr.1676, datë 24.12.2008 | Për shpronësimin, për interes publik, të pronareve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor rrethrrotullimi, Lezhe………………………………………………. | 10982 |
| Vendim i KM nr.1677, datë 24.12.2008 | Për shpronësimin për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga ndërtimi i stacionit të pompimit, Tushemisht, Pogradec…………………………………… | 10984 |
| Vendim i KM nr.1679, datë 24.12.2008 | Për kriteret dhe procedurat e përcaktimit të statusit të organizatave jofitimprurëse, për përfitim publik…………………………………… | 10985 |
| Udhëzim i MF nr.17/4, datë 26.12.2008 | Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr.17, datë 13.5.2008 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar"…………………………………….. | 10987 |

**VENDIM**
**Nr.1646, datë 24.12.2008**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA ZGJERIMI I VARREZAVE NË KOMUNËN XHAFZOTAJ, DURRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zgjerimi i varrezave në komunën Zhafzotaj, Durrës.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të komunës Xhafzotaj. Regjistrimi i ri i pasurisë, 2000 (dy mijë) $m^2$, tokë/arë, të bëhet brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi e këtij vendimi.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 2000 (dy mijë) $m^2$, tokë/arë, me vlerë të përgjithshme shpronësimi 2 500 000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë.

4. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga komuna Xhafzotaj.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 2 500 000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë, të përballohet nga të ardhurat e komunës Xhafzotaj, planifikuar në buxhetin e vitit 2008.

6. Afati i përfundimit të procedurës së shpronësimit të jetë tre muaj pas hyrjes në fuqi të vendimit.

7. Afati i përfundimit të punimeve në objektin "Zgjerimi i varrezave publike të komunës" të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga komuna Xhafzotaj, për realizimin e këtij projekti.

8. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Xhafzotaj për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

TË DHËNAT MBI LISTËN EMËRORE TË PRONARËVE DHE PRONAVE QË DO TË SHËPRONËSOHEN PËR ZGJERIMIN E VARREZAVE PUBLIKE, NË KOMUNËN

XHAFZOTAJ

| Nr. | Emër,mbiemër | Sipërfaqja në $m^2$ | Çmimi në lekë | Vlera | Lloji i dokumentit | Zona kadastrale | Nr.pasurisë |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Fiqeri Bregu | 400 | 1250 | 500 000 | cert.pronësie | 3852 | 110/1 |
| 2 | Rahman Neziri | 680 | 1250 | 850 000 | cert.pronësie | 3852 | 110/35 |
| 3 | Gani Nerjaku | 729 | 1250 | 911 250 | cert.pronësie | 3852 | 110/33 |
| 4 | Gani Nerjaku | 191 | 1250 | 238 750 | cert.pronësie | 3852 | 110/31 |
| | **Shuma në total** | **2000** | **1250** | **2 500 000** | | | |

**VENDIM**
**Nr.1649, datë 24.12.2008**

## PËR SHTYRJEN E AFATIT TË BOTIMIT TË NJOFTIMIT TË FITUESIT DHE NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË LIDHUR, PËR PROCEDURAT E PROKURIMIT, TË KRYERA NGA DREJTORIA E PËRGJITHSHME E UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE, BASHKI, KOMUNA E KËSHILLI I QARKUT TË DIBRËS, SI AUTORITETE KONTRAKTUESE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjellës-kanalizimeve, të bashkive, komunave dhe këshillit të qarkut të Dibrës të shtyjnë afatin e botimit të njoftimit të fituesit dhe të njoftimit të kontratës së lidhur, deri më 31 dhjetor 2008, për procedurat e prokurimit të fondeve buxhetore të investimeve, për 16 objekte, sipas listës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës-kanalizimeve, Agjencia e Prokurimit Publik, bashkitë, komunat dhe këshilli i qarkut të Dibrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
Drejtoria e Përgjithshme Ujësjellës-kanalizimeve

| Nr. | Emërtimi i projektit | Komuna/bashkia | Vlera e plotë e projektit |
|---|---|---|---|
| | Granti konkurrues, Objekte të reja | | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 1 | Ndërtim KUB fshati Hamallaj, bashkia Manëz | bashkia Manëz | 34,250 |
| 2 | Rikonstruksion Ujësjellësi Çlirim, komuna qendër Fier | komuna Qendër | 24,344 |
| 3 | Rikonstruksion i ujësjellësit të fshatit Petrelë, komuna Petrelë | komuna Petrelë | 36,255 |
| 4 | Kuz Lundër, komuna Farkë | komuna Farkë | 39,230 |
| 5 | Kuz dhe KUB të rrugës "Rruga nacionale-Mjull Bathore", Komuna Farkë | komuna Farkë | 16,479 |
| 6 | Ujësjellësi rajonal Aliko, komuna Aliko, Sarandë | komuna Aliko | 98,140 |
| 7 | Ujësjellësi i fshatit Korre, komuna Funar, Elbasan | komuna Funar | 9,587 |
| 8 | Ndërtim ujësjellësi Sopanike (varianti me vetërrjedhje), objekt në vazhdim | këshilli i qarkut Dibër | 24,317 |
| 9 | Ujësjellësi i fshatit Arzë, komuna Miras, Korçë | komuna Miras | 18,000 |
| 10 | Përfundimi i ujësjellësit Patin, bashkia Klos | bashkia Klos | 16,816 |
| 11 | Rikonstruksion ujësjellësi i fshatit Hotoloshit-Qendër, komuna Hotoloshit, Librazhd | komuna Hotoloshit | 4,989 |
| 12 | Linja e re e ujësjellësit Piskovë, komuna Piskovë, Gjirokastër | komuna Piskovë | 3,174 |
| 13 | KUZ zona a banimit "Ura e Beshirit", komuna Ndroq, Tiranë | komuna Ndroq | 55,700 |
| 14 | KUZ të fshatrave Marqinet-Gërdec, bashkia Vorë | bashkia Vorë | 92,065 |
| 15 | Rikonstruksion i ujësjellësit të fshatrave Gërdec, Marqinet 2 dhe Marqinet 1, bashkia Vorë | bashkia Vorë | 89,901 |
| 16 | Rrjeti i ri i KUZ të fshatit Mbrostar-Ura (faza e parë), komuna Mbrostar, Fier | komuna Mbrostar | 56,764 |

## VENDIM
## Nr.1650, datë 24.12.2008

## PËR SHTYRJEN E AFATIT TË BOTIMIT TË NJOFTIMIT TË FITUESIT DHE NJOFTIMIT TË KONTRATËS SË LIDHUR, PËR TRI PROCEDURA PROKURIMI, TË KRYERA NGA DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE, SI AUTORITET KONTRAKTUES

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve të shtyjë afatin e botimit të njoftimit të fituesit dhe të njoftimit të kontratës së lidhur, deri më 31 dhjetor 2008, për tri procedura prokurimi, sipas tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Agjencia e Prokurimit Publik, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

LISTA E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PËR TË CILAT KËRKOHET SHTYRJE AFATI

| Nr. | Emërtimi i objektit prokurimit | Forma e prokurimit |
|---|---|---|
| 1. | Studimi, projektimi, rishikimi i projektit tri urat Leskovik (neg. pa shpallje) | Shkresor |
| 2. | Stud. projektim ndërt. ura e Drinit në aksin Kalimash-Kukës (neg. pa shpallje) | Shkresor |
| 3. | Shërbim me roje civile (BeHaSe, godina e DPRR) (neg. pa shpallje) | Shkresor |

**VENDIM**
**Nr.1655, datë 24.12.2008**

**PËR SHPËRBLIMIN E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË ZËNA NGA NDËRTIMET INFORMALE, DHE PËR SIPËRFAQET TAKUESE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 15/1 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpërblimin e pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të zëna nga ndërtimet informale, në qarqet e Tiranës, të Shkodrës dhe të Elbasanit.

2. Pronarët e pasurive të paluajtshme, për sipërfaqen e zënë nga ndërtimet informale, të shpërblehen, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përkatësisht, për sipërfaqen 27 935,46 (njëzet e shtatë mijë e nëntëqind e tridhjetë e pesë, pikë dyzet e gjashtë) $m^2$, tokë truall, me vlerë të përgjithshme, 464 899 696 (katërqind e gjashtëdhjetë e katër milionë e tetëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë.

3. Vlera e përgjithshme për shpërblimin të përballohet nga fondi i kompensimit të pronave, të parashikuar nga ligji nr.9235, datë 29.7.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", të ndryshuar.

4. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, në përputhje me këtë vendim, të bëjë ndryshimet përkatëse në regjistrat e pasurive të paluajtshme, për kalimin e pasurisë së paluajtshme të kompensuar, në pronësi të shtetit.

5. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave/Ndërtimeve Informale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

LISTA EMËRORE NR.2 E PRONARËVE DHE SIPËRFAQET TAKUESE PËR SHPËRBLIM

| **Nr. i pronarëve** | **Emri Atësia Mbiemri** | **Numri i zonës kadastrale** | **Numri i pasurisë** | **Sip. e parce lës që do të shpërblehet ($m^2$)** | **Vlera e shpërblimit (lekë)** |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 |
| QARKU I TIRANËS | | | | | |
| 1 | Fadil Hamiti | 8320 | 13/314 | 12438.46 | 254652592.00 |
| 2 | Rabije Hamiti | | 13/309 | | |
| 3 | Nadire Hamiti | | 13/310 | | |
| 4 | Fatmir Hamiti | | 14/137 | | |
| 5 | Gjyle Hamiti | | 13/311 | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 6 | Nafije Hamiti | | 13/312 | | |
| 7 | Servete Hamiti | | 13/313 | | |
| 8 | Mimoza Hamiti | | | | |
| 9 | Xhevaire Hamiti | | | | |
| 10 | Floresha Hamiti | | | | |
| 11 | Vladimir Hamiti | | | | |
| 12 | Adelina Hamiti | | | | |
| 13 | Klotilda Hamiti | | | | |
| 14 | Klodjan Hamiti | | | | |
| QARKU I SHKODRËS | | | | | |
| 15 | Azem Abdullah Toka | 8591 | 17/626 | 300.00 | 6469200.00 |
| 16 | Hava Malevija | 8591 | 17/951 | 323.00 | 6965172.00 |
| 17 | Daut Malevija | | | | |
| 18 | Shuajp Malevija | | | | |
| 19 | Rifat Malevija | | | | |
| 20 | Halit Jula | | | | |
| 21 | Satber Jula | | | | |
| 22 | Bardhyl Jula | | | | |
| 23 | Ermira Jula | | | | |
| 24 | Hatixhe Malevija | 8591 | 17/966 | 247.00 | 5326308.00 |
| 25 | Ahmet Malevija | | | | |
| 26 | Lutfi Malevija | | | | |
| 27 | Eqerem Malevija | | | | |
| 28 | Isak Malevija | | | | |
| 29 | Fazilet Malevija | | | | |
| 30 | Avidana Malevija | | | | |
| 31 | Nafije Malevija | | | | |
| 32 | Fatbardha Malevija | | | | |
| 33 | Neziha Malevija | | | | |
| 34 | Genc Malevija | | | | |
| 35 | Naile Malevija | | | | |
| 36 | Sebiha Malevija | | | | |
| 37 | Arta Malevija | | | | |
| 38 | Albana Malevija | | | | |
| 39 | Kimete Malevija | | | | |
| 40 | Ejup Malevija | | | | |
| 41 | Esat Malevija | | | | |
| 42 | Agime Shabani | 8591 | 17/615 | 168.00 | 3622752.00 |
| 43 | Lumnije Shabani | | | | |
| 44 | Agime Shabani | 8591 | 17/616 | 300.00 | 6469200.00 |
| 45 | Lumnije Shabani | | | | |
| 46 | Teofik Jonuz Malevija | 8591 | 17/467 | 356.00 | |
| 47 | Ismail Jonuz Malevija | | | | |
| 48 | Kimete Jonuz Malevija | | | | |
| 49 | Ejup Jonuz Malevija | | | | |
| 50 | Esat Jonuz Malevija | | | | |
| 51 | Hava Qazim Malevija | | | | |
| 52 | Daut Qazim Malevija | | | | |
| 53 | Rifat Qazim Malevija | | | | |
| 54 | Hajrullah Qazim Malevija | | | | |
| 55 | Halit Ahmet Malevija | | | | |
| 56 | Ermira Halit Malevija | | | | |
| 57 | Bardhyl Halit Malevija | | | | 7676784.00 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 58 | Satber Halit Malevija | | | | |
| 59 | Hysen Osman Malevija | | | | |
| 60 | Shevqet Osman Malevija | | | | |
| 61 | Halit Osman Malevija | | | | |
| 62 | Bajram Osman Malevija | | | | |
| 63 | Milihat Osman Malevija | | | | |
| 64 | Nazmi Osman Malevija | | | | |
| 65 | Ylfet Qazim Malevija | | | | |
| 66 | Durrije Qazim Malevija | | | | |
| 67 | Ali Qazim Malevija | | | | |
| 68 | Zija Qazim Malevija | | | | |
| 69 | Shuajp Qazim Malevija | | | | |
| 70 | Teofik Jonuz Malevija | 8591 | 17/468 | 266.6 | 5748962.00 |
| 71 | Ismail Jonuz Malevija | | | | |
| 72 | Kimete Jonuz Malevija | | | | |
| 73 | Ejup Jonuz Malevija | | | | |
| 74 | Esat Jonuz Malevija | | | | |
| 75 | Hava Qazim Malevija | | | | |
| 76 | Daut Qazim Malevija | | | | |
| 77 | Rifat Qazim Malevija | | | | |
| 78 | Hajrullah Qazim Malevija | | | | |
| 79 | Halit Ahmet Malevija | | | | |
| 80 | Ermira Halit Malevija | | | | |
| 81 | Bardhyl Halit Malevija | | | | |
| 82 | Satber Halit Malevija | | | | |
| 83 | Hysen Osman Malevija | | | | |
| 84 | Shefqet Osman Malevija | | | | |
| 85 | Halit Osman Malevija | | | | |
| 86 | Bajram Osman Malevija | | | | |
| 87 | Milihat Osman Malevija | | | | |
| 88 | Nazmi Osman Malevija | | | | |
| 89 | Ylfet Qazim Malevija | | | | |
| 90 | Durrije Qazim Malevija | | | | |
| 91 | Ali Qazim Malevija | | | | |
| 92 | Zija Qazim Malevija | | | | |
| 93 | Shuajp Qazim Malevija | | | | |
| 94 | Behran Isufi | 8591 | 17/416 | 316.2 | 6818537.00 |
| QARKU I ELBASANIT | | | | | |
| 95 | Rexhep Demir Peni | 8521 | 16/296 | 1977.30 | 23986626.00 |
| 96 | Naferit Demir Peni | | | | |
| 97 | Bekim Gjergji Shyti | | | | |
| 98 | Deje Demir Peni | | | | |
| 99 | Ibrahim Hysen Pajenga | 8521 | 1/188 | 99.2 | 1979338.00 |
| 100 | Sadete Perihana | | | 542 | 6575002.00 |
| 101 | Ibrahim Perihana | | | | |
| 102 | Valbona Perihana | | | | |
| 103 | Bashkim Perihana | 8521 | 11/117 | | |
| 104 | Gani Lulja | 8521 | 11/101 | | |
| 105 | Rudina Lulja | | | | |
| 106 | Samir Perihana | | | | |
| 107 | Delina Perihana | | | | |
| 108 | Fitnet Perihana | | | | |
| 109 | Suzi Begeja | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 110 | Skënder Çaka | | | 1271.9 | 15429419.00 |
| 111 | Shefikat Çaka | | | | |
| 112 | Ruzhdije Çaka | | | | |
| 113 | Rahmije Çaka | 8521 | 16/255 | | |
| 114 | Nadire Çaka | | | | |
| 115 | Bedrije Çaka | | | | |
| 116 | Hatixhe Çaka | | | | |
| 117 | Symir Demiri | | | 3907.6 | 47403096.00 |
| 118 | Albert Palloshi | | | | |
| 119 | Ryzhdi Demiri | 8521 | 16/255 | | |
| 120 | Afërdita Josifi | | | 5422.2 | 65776708.00 |
| 121 | Jorgji Venemin Josifi | | | | |
| 122 | Ernest Josifi | | | | |
| 123 | Veron Hasan Duma | 8521 | 16/293 | | |
| 124 | Melita Hasan Duma | | | | |
| 125 | Naftali Papajani | | | | |
| 126 | Lazer Papajani | | | | |
| Shuma totale | | | | 27935.46 | 464899696.00 |

**VENDIM**
**Nr.1656, datë 24.12.2008**

**PËR MIRATIMIN E FONDIT PËR LIKUIDIMIN E PAGESAVE TË PRAPAMBETURA PËR PUNONJËSIT E NDËRMARRJES SHTETËRORE, ISH- KOMBINATI I TEKSTILEVE, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.7582, datë 13.7.1992 "Për ndërmarrjet shtetërore", të ndryshuar, të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008", të ndryshuar, dhe të nenit 44 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e fondit, 9 600 000 (nëntë milionë e gjashtëqind mijë) lekë për investime (konservim), për likuidimin e pagave dhe të detyrimeve të prapambetura për punonjësit e ndërmarrjes shtetërore, ish-Kombinati i Tekstileve, Tiranë, sipas tabelave 1 e 2, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ky fond përfshin pagat e prapambetura, sigurimet, shoqërore e shëndetësore, dhe tatimin mbi pagë, për periudhën prill-dhjetor 2006, si dhe vitet 2007 e 2008.

3. Fondi, 9 600 000 (nëntë milionë e gjashtëqind mijë) lekë, të përballohet nga buxheti i

investimeve, i vitit 2008, programi “Strehim dhe urbanistikë”, miratuar për Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

4. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

Tabela nr.1

Tabela e pagave e punonjësve të ndërmarrjeve të ish-kombinatit tekstil, Tiranë
Ndërmarrja e tekstileve të pambukta

| **Emër, mbiemër** | **Detyra** | **Paga** | **Muaj** | **Fondi i pagave** | **Kontributi i sigurimeve shoqërore** | | | **Shuma neto** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | **11,2** | **21,7** | **Tatimi mbi pagë** | |
| Ram Muhadri | drejtor | 60.000 | 13 | 780.000 | 87.360 | 209.280 | 44.720 | 647.920 |
| Xhemile Basha | K/d Fin | 45.000 | 32 | 1.440.000 | 161.280 | 332.117 | 100.636 | 1.178.084 |
| Liri Aliçkolli | magazi | 30.000 | 27.5 | 825.000 | 92.400 | 191.111 | 39.325 | 693.275 |
| Xhemal Koçi | rojë | 20.000 | 32 | 640.000 | 71 .680 | 147.608 | 29.815 | 538.505 |
| Luzim Çollaku | rojë | 20.000 | 32 | 640.000 | 71 .680 | 147.608 | 29.815 | 538.505 |
| Redjon Dervishi | rojë | 20.000 | 19 | 380.000 | 42.560 | 91.188 | 15.910 | 321 .530 |
| Kujtim Cena | rojë | 20.000 | 17 | 340.000 | 39.200 | 89.290 | 7.480 | 293.320 |
| Gëzim Sula | rojë | 20.000 | 17 | 340.000 | 39.200 | 89.290 | 7.480 | 293.320 |
| | | | | | | | | |
| | | | | 5.385.000 | 605.360 | 1.295.000 | 275.181 | 4.504.459 |

Ndërmarrje mekanike e tekstileve

| **Emër mbiemër** | **Detyra** | **Paga** | **Muaj** | **Fondi i pagave** | **Kontributi i sigurimeve shoqërore** | | | **Shuma** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | **11,2** | **21,7** | **Tatimi mbi pagë** | |
| Lida Mara | Drejtor | 60.000 | 30 | 1.800.000 | 201.600 | 390.000 | 103.200 | 1.495.200 |
| Liri Kenga | Punt/llog | 20.000 | 30 | 600.000 | 67.200 | 130.000 | 13.200 | 519.600 |
| | | | | | | | | |
| | | | | 2.400.000 | 268.800 | 520.000 | 1.164.400 | 2.014.800 |

Fondi i pagave 9.600.000 lekë
Ndarë në

Paga 7.785.000 lekë
Sigurime shoqërore 1.815.000 lekë

Tabela nr.2

Ndërmarrja e tekstileve të pambukta
Tiranë
Fondi i pagave dhe sigurimeve shoqërore për periudhën 1.4-31.12.2006 viti 2007 dhe viti 2008

| Nr. | Emërtimi | Nr.punonjësve, fondi vjetor i pagave | | Sig.shoqërore |
|---|---|---|---|---|
| | | | | 21.7 |
| | Viti 2006 | 8 | 2,115,000 | 564,705 |
| 1. | Administ | 3 | 1,215,000 | 324,405 |
| 2. | Rojë | 5 | 900,000 | 240,300 |
| | Viti 2007 | 5 | 2,180,000 | 494,760 |
| 1. | Administ | 1 | 1,140,000 | 260,400 |
| 2. | Rojë | 4 | 1,040,000 | 234,360 |
| | Viti 2008 | 3 | 1,620,000 | 351,540 |
| | Administ | 1 | 630,000 | 136,710 |
| | Rojë | 2 | 460,000 | 99,810 |
| | | | | |
| | Totali | | 5,385,000 | 1,295,000 |

Ndërmarrja mekanike e tekstilit
Tiranë
Fondi pagave dhe sigurimeve shoqërore periudha 1.7-31.2.2006 viti 2007 dhe viti 2008

| Nr. | Emërtimi | Nr.punonjësve, fondi vjetor i pagave | | Sig.shoqërore |
|---|---|---|---|---|
| | | | | 21.7 |
| | Viti 2006 | 2 | 480,000 | 104,000 |
| 1 | Administ | 1 | 360,000 | 78,000 |
| 2 | Rojë | 1 | 120,000 | 26,000 |
| | Viti 2007 | 2 | 960,000 | 208,000 |
| 1. | Administ | 1 | 720,000 | 156,000 |
| 2. | Rojë | 1 | 240,000 | 52,000 |
| | Viti 2008 | 2 | 960,000 | 208,000 |
| | Administ | 1 | 720,000 | 156,000 |
| | Rojë | 1 | 240,000 | 52,000 |
| | | | | |
| | Totali | | 2,400,000 | 520,000 |

Shënim: Ndërmarrja e Tekstileve të pambukta nga muaji maj 2007 e në vazhdim nuk ka pasur drejtor.

Pagat: Drejtori 60,000 lekë
Financieri 45,000 lekë
Magazinieri 30,000 lekë
Roja 20,000 lekë

**VENDIM**
**Nr.1658, datë 24.12.2008**

**PËR DISA NDRYSHIME E SHTESA NË VENDIMIN NR.306, DATË 27.6.2002 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE ME ARSIM TË LARTË NË SISTEMIN E MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE SPITALIN USHTARAK QENDROR UNIVERSITAR, NË SISTEMIN E MINISTRISË SË MBROJTJES", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për

kompetencat për caktimin e pagave të punës", të ndryshuar, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.306, datë 27.6.2002, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime e shtesa:

a) Kreu 1.1 i lidhjes nr.1 "Strukura e pagave për punonjësit me arsim të lartë në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë, Spitalin Universitar Obstetrik Gjinekologjik nr.1 e nr.2, Tiranë, Spitalin Universitar të Sëmundjeve të Mushkërive "Shefqet Ndroqi", Tiranë, Klinikën Stomatologjike Universitare, Tiranë, Spitalin Ushtarak Qendror Universitar, Tiranë", zëvendësohet me kreun me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Titulli i kreut 1.9, në lidhjen nr.1, që përmendet në pikën 1 të vendimit, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Struktura e pagave për punonjësit me arsim të lartë në Qendrën Kombëtare të Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore dhe në Qendrën Kombëtare të Edukimit në Vazhdim, të punonjësve të shëndetësisë.".

c) Në pikën 4 bëhen këto ndryshime:

i) Paragrafi i parë ndryshohet, si më poshtë vijon:

"Punonjësit me arsim të lartë, në sistemin shëndetësor, të cilët trajtohen me pagë, sipas lidhjes nr.1 (krerët 1.2, 1.3, 1.4, 1.5, 1.6, 1.7, 1.8, 1.9 e 1.10), si dhe punonjësit me arsim të lartë të personelit jomjekësorë, që trajtohen në pagë, sipas lidhjes nr.1, kreu 1.1, përfitojnë shtesë për kualifikimin, gradën apo titullin shkencor, në masën e përcaktuar në lidhjen nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.".

ii) Para paragrafit të fundit shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

"Punonjësit e personelit mjekësor, që trajtohen me pagë, sipas lidhjes nr.1, kreu 1.1, përfitojnë shtesën për kualifikimin "Master i nivelit të dytë/studime të thelluara pasuniversitare/studime specializuese afatgjata", sipas lidhjes nr.2 dhe kritereve të përcaktuara në shkronjën "a".".

ç) Pas pikës 6/1 shtohet pika 6/2, me këtë përmbajtje:

"6/2. Shtesën për kushte pune, në masën 8 000 (tetë mijë) lekë, që përfitojnë punonjësit e shërbimit infektiv në QSUT, e përfitojnë edhe mjekët me tituj e grada shkencore, që janë pjesë e këtij shërbimi, të cilët trajtohen me pagë me vendimin nr.1231, datë 2.7.2008 të Këshillit të Ministrave "Për pagat e punonjësve mbështetës në institucionet buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore".".

2. Efektet financiare, për paga e sigurime shoqërore, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të fillojnë nga data 1 korrik 2008 dhe të përballohen nga fondet e parashikuara në buxhetin e vitit 2008, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë.

3. Efekti financiar, për paga e sigurime shoqërore, që rrjedh nga zbatimi i këtij vendimi, për shtesën për kushte pune të punonjësve të shërbimit infektiv në QSUT, të fillojë nga data 1 janar 2009 dhe të përballohet nga fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit, të vitit 2009, miratuar për sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

LIDHJA NR.1 (Kreu 1.1)

STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT ME ARSIM TË LARTË NË QENDRËN SPITALORE UNIVERSITARE "NËNË TEREZA" TIRANË, SPITALI UNIVERSITAR OBSETRIK GJINEKOLOGJIK NR.1, NR.2 TIRANË, SPITALI UNIVERSITAR I SËMUNDJEVE TË MUSHKËRIVE "SHEFQET NDROQI" TIRANË, KLINIKA STOMATOLOGJIKE UNIVERSITARE TIRANË, SPITALI USHTARAK QENDROR UNIVERSITAR TIRANË

| | | PAGA MUJORE | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **PAGA INDIVIDUALE** | | | **SHTESA E POZICIONIT** | | |
| | **EMËRTIMI** | **Paga e grupit (PG)** | **Shtesa për vjetersi (SHV)** | **Shtesa për kualifikim (SHK)** | **Shtesa për pozicion (SHP)** | **Shtesa për kushte punë (SHKP)** | **Totali** |
| | | **1** | **2** | **3** | **4** | **5** | |
| 1 | Drejtor<br>- QSU "Nënë Tereza" Tiranë<br>- Spitali Universitar Obstetrik Gjinekologjik "Mbretëresha Geraldinë" Tiranë<br>- Spitali Universitar Obsetrik Gjinekologjik "Koço Glozheni" Tiranë<br>- Spitali i sëmundjeve të Mushkërisë "Shefqet Ndroqi" Tiranë | 11 000 | 2% | | 86 500 | | Nga..deri lekë |
| 2 | Drejtor<br>- Klinika Stomatologjike Universitare Tiranë | 11 000 | 2% | | 58 300 | | Nga..deri lekë |
| 3 | Zëvendësdrejtor | 11 000 | 2% | | 49 500 | | Nga..deri lekë |
| 4 | Shef shërbimi infektiv në QSUT | 11 000 | 2% | | 41 000 | 8000 | Nga. deri lekë |
| 5 | Shef shërbimi<br>Shef i sektorit biomedikal | 11 000 | 2% | | 41 000 | | Nga..deri lekë |
| 6 | Shef reparti infektiv në QSUT | 11 000 | 2% | | 38 500 | 8000 | Nga..deri lekë |
| 7 | Shef reparti/klinike (kirurgji, urgjencë etj.)<br>Shef i qendrës së gruas | 11 000 | 2% | | 38 500 | | Nga..deri lekë |
| 8 | Shef reparti/klinike reanimacioni | 11 000 | 2% | | 38 500 | 1100 | Nga..deri . . lekë |
| 9 | Shef reparti/klinike psikiatrie | 11 000 | 2% | | 38 500 | 5000 | Nga..deri . . . lekë |
| 10 | Shef i laboratorit klinik biokimik<br>Shef reparti kimioterapi<br>Shef laboratori<br>Shef i qendrës së diagnozës molekulare | 11 000 | 2% | | 38 500 | 2200 | Nga. . deri lekë |
| 11 | Shef reparti rrezatimi<br>Shef reparti i kyrisë | 11 000 | 2% | | 38 500 | 4600 | Nga..deri . . . lekë |
| 12 | Shef kabineti<br>Shef i qendrës së protezimit<br>Inxhinier biomedikal | 11 000 | 2% | | 36 000 | | Nga..deri . . . lekë |
| 13 | Shef sektori<br>Shef farmacie në solucionet e injektueshme<br>Biokimist në solucionet e injektueshme<br>Inxhinier i sistemeve të ngrohjes<br>Inxhinier hemodialize | 11 000 | 2% | | 30 000 | | Nga..deri . . . lekë |
| 14 | Mjek<br>Stomatolog.<br>Biolog, kimist, fizikan në preparatori<br>Mikrobiolog, parazitolog, | 11 000 | 2% | | 26 500 | | Nga..deri . . . lekë |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | virolog, mykolog<br>Përgjegjës qendre DDD<br>Specialist fizkulture (fizioterapi neurologji).<br>Kryellogaritar<br>Revizor | | | | | | |
| 15 | Mjek infeksionist në QSUT | 11 000 | 2% | | 26 500 | 8000 | Nga..deri . . . lekë |
| 16 | Mjek kirurg (specialitete kirurgjikale)<br>Mjek onkolog<br>Mjek fizioterapevt<br>Mjek obseter gjinekolog<br>Mjek pneumoftiziatër | 11 000 | 2% | | 26 500 | 1100 | Nga..deri . . . lekë |
| 17 | Mjek radiolog<br>Toksikolog, kimist,në laboratorin toksikologjik<br>Kimist në laboratorin biokimik<br>Fizikan në laboratorin biokimik<br><br>Biolog në laboratorin biokimik | 11 000 | 2% | | 26 500 | 1600 | Nga..deri . . . lekë |
| 18 | Mjek radiolog në shërbimin infektiv në QSUT.<br>Mjek në kabinetin e ekografisë, në shërbimin infektiv në QSUT | 11 000 | 2% | | 26 500 | 8000 | Nga..deri . . . lekë |
| 19 | Mjek kimioterapevt<br>Mjek hematolog<br>Mjek infeksionist<br>Mjek në pranim urgjence<br>Mjek në njësinë nozokomiale<br>Mjek laboratori<br>Mjek histopatolog<br>Mjek në shërbimin e gjakut | 11 000 | 2% | | 26 500 | 2000 | Nga..deri . . . lekë |
| 20 | Mjek në inspektoratin sanitar<br>Inspektor sanitar<br>Epidemiolog<br>Farmacist | 11 000 | 2% | | 26 500 | 2500 | Nga..deri . . . lekë |
| 21 | Farmacist në laboratorin toksikologjik<br>Mjek laboratori izotopik<br>Fizikant,kimist laboratori izotopik<br>Mjek në hemodinamikë<br>Fizikan në higjienë dhe epidemilogji<br>Inxh-kimist në shërbimin e higjienës në SUQU<br>Biokimist në shërbimin e mbrojtjes nukleare biokimike në SUQU | 11 000 | 2% | | 26 500 | 2800 | Nga..deri . . . lekë |
| 22 | Mjek anatomopatolog<br>Mjek anestezist, reanimator<br>Mjek në pavionin e rrezatimit<br>Mjek në pavionin e kyrisë | 11 000 | 2% | | 26 500 | 3700 | Nga..deri . . . lekë |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Specialist në qendrën e diagnozës molekulare Fizikan kobalti | | | | | | |
| 23 | Mjek, psikologë, punonjës social që punojnë në psikiatri | 11 000 | 2% | | 26 500 | 5000 | Nga..deri . . . lekë |
| 24 | Specialist i lartë | 11 000 | 2% | | 25 000 | | Nga..deri . . . lekë |

**VENDIM**
**Nr.1659, datë 24.12.2008**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I RRUGËS KARDHIQ-DELVINË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i rrugës Kardhiq-Delvinë.
2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për objekte, me vlerë 2 005 032 (dy milionë e pesë mijë e tridhjetë e dy) lekë, për kultura bujqësore, me vlerë 836 359 (tetëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e treqind e pesëdhjetë e nëntë) lekë.
4. Shpenzimet procedurale, në shumën 647 500 (gjashtëqind e dyzet e shtatë mijë e pesëqind) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.
5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 2 841 391 (dy milionë e tetëqind e dyzet e një mijë e treqind e nëntëdhjetë e një) lekë, të përballohet nga zëri "Shpronësime", miratuar për Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.
6. Shpronësimi të fillojë më 30 dhjetor 2008 dhe të përfundojë më 30 mars 2009.
7. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të bëjë likuidimin e pronarëve brenda afatit të parashikuar në pikën 6 të këtij vendimi.
8. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

REPULIKA E SHQIPËRISË
M.P.P. TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE DREJTORIA JURIDIKE
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR KARDHIQ - DELVINË"

Qarku Gjirokastër, rrethi Gjirokastër, komuna CEPO, fshati PLESAT

| NR. | PRONARI | | | Z.K | NR. PAS | SIP.$M^2$ | KULTURA BUJQËSORE | VLERA LEKË | SHËNIME |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Emri | Atësia | Mbiemri | | | | | | |
| 1. | LESKO | EMIN | HIDA | 2989 | 29/7 | 92 | 1380 | 1380 | KONFIRMUAR NGA ZRPP |
| 2. | FEIM | TAJAR | DURO | 2989 | 32/2 | 980 | 22050 | 22050 | KONFIRMUAR NGAZRPP |
| 3. | SHAQO | ABEDIN | ZHOLI | 2989 | 29/5 | 89 | 2227 | 2227 | KONFIRMUAR NGA ZRPP |
| 4. | HYSEN | XHIPE | BATHA | 2989 | 29/2 | 284 | 6390 | 6390 | KONFIRMUAR NGA ZRPP |
| 5. | ARSHI | XHIPE | BATHA | 2989 | 29/3 | 84 | 2400 | 2400 | KONFIRMUAR NGA ZRPP |
| 6. | BARJAM | TAJAR | DURO | 2989 | 32/1 | 846 | 18975 | 18975 | KONFIRMUAR NGAZRPP |
| | | Totali | | | | 2375 | 53422 | 53422 | |

MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT, TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA E PERGJITHSHME E RRUGËVE

DREJTORIA JURIDIKE
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARIT QË SHPRONËSOHET PËR TRUALL DHE OBJEKT NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR "KARDHIQ - DELVINË

Qarku Gjirokastër, rethi Gjirokastër, komuna CEPO, fshati KODËR

| Nr. | Pronari | | | Z.K | NR.PAS. | Tokë truall | | | Objekt vlera | Totali lekë | Shënime |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Emri | Atësia | Mbiemri | | | Sip.$M^2$ | Çmimi | Vlera | | | |
| 1 | Azis | QAZIM | VEIZI | 2174 | 13/32 | 300 | 1667 | 500100 | 1504932 | 2005032 | KONFIRMUAR NGA ZVRPP |
| | Totali | | | | | 300 | | 500100 | 1504932 | 2005032 | |

REPULIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA JURIDIKE
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE
KARDHIQ - DELVINË"

QARKU GJIROKASTËR, RRETHI GJIROKASTËR, KOMUNA CEPO, FSHATI PRONGJI

| NR. | PRONARI | | | Z.K. | NR. PAS. | SIP.$m^2$ | KULTURA BUJQËSORE | TOTALI | SHËNIME |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | EMRI | ATËSIA | MBIEMRI | | | | | | |
| 1 | NAMIK | TAFIL | KASI | 3058 | 223 | 221 | 4972 | 4972 | KONFIRMUAR NGA ZRPP |
| 2 | SIRI | REXHEP | RUCI | 3058 | 289/1 | 1805 | 54600 | 54600 | KONFIRMUAR NGA ZRPP |
| 3 | GURABI | SHAMET | LIKU | 3058 | 293/11 | 175 | 2600 | 2600 | KONFIRMUAR NGA ZRPP |
| 4 | JAHO | FERIK | SHKRELI | 3058 | 286/3 | 1812 | 33975 | 33975 | KONFIRMUAR NGA ZRPP |
| TOTALI | | | | | | **4013** | **96147** | **96147** | |

REPULIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHESHME E RRUGËVE
DREJTORIA JURIDIKE
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR "KARDHIQ - DELVINE"
Qarku Gjirokasër, rrethi Gjirokastër, komuna Cepo, fshati Kodër

| NR | PRONARI | | | Z.K. | NR. PAS. | SIP.m$^2$ | KULTURA BUJQËSORE | DRU FRUTORË | Vlera lekë | SHËNIME |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | EMRI | ATËSIA | MBIEMRI | | | | | | | |
| 1. | AJAZ | XHELO | HASKA | 2174 | 41/6 | 490 | 11025 | | 11025 | KONFIRMUAR NGA ZRPP |
| 2. | RESHAT | KALO | SADIKU | 2174 | 39/4 | 1138 | 25575 | | 25575 | KONFIRMUAR NGA ZRPP |
| 3. | HYSEN | VEIP | SHEHU | 2174 | 43/12 | 368 | 15750 | | 15750 | KONFIRMUAR NGA ZRPP |
| 4. | RUSHIT | RAPO | MAJKO | 2174 | 43/10 | 1390 | 20800 | | 20800 | KONFIRMUAR NGA ZRPP |
| 5. | HALIT | MERSIN | BIZHGA | 2174 | 43/6 | 228 | 6840 | | 6840 | KONFIRMUAR NGA ZRPP |
| 6. | ARTUR | SHAMET | BURNACI | 2174 | 43/7 | 471 | 7060 | | 7060 | KONFIRMUAR NGA ZRPP |
| 7. | ARTUR | SHAMET | BURNACI | 2174 | 21/6 | 578 | 8670 | | 8670 | KONFIRMUAR NGA ZRPP |
| 8. | NUSTRET | XHEMAL | NOVI | 2174 | 21/7 | 1530 | 2290 | | 2290 | KONFIRMUAR NGA ZRPP |
| 9. | NAZIF | SINAN | MIXHA | 2174 | 41/9 | 126 | 1890 | | 1890 | KONFIRMUAR NGA ZRPP |
| 10. | EDMOND | RESHAT | SADIKU | 2174 | 39/6 | 951 | 21375 | | 21375 | KONFIRMUAR NGA ZRPP |
| 11. | EDMOND | RESHAT | SADIKU | 2174 | 21/3 | 363 | 5440 | | 5440 | KONFIRMUAR NGA ZRPP |
| 12. | MUIN | ZENEL | NOVI | 2174 | 21/5 | 680 | 15300 | | 15300 | KONFIRMUAR NGA ZRPP |
| 13. | AGRON | SINAN | MIXHA | 2174 | 40/3 | 100 | 1250 | | 1250 | KONFIRMUAR NGA ZRPP |
| 14. | AGRON | SINAN | MIXHA | 2174 | 40/1 | 326 | 4100 | | 4100 | KONFIRMUAR NGA ZRPP |
| 15 | AGRON | SINAN | MIXHA | 2174 | 41/7 | 334 | 7500 | | 7500 | KONFIRMUAR NGA ZRPP |
| 16 | PETRIT | MYRTEZA | NOVI | 2174 | 39/7 | 556 | | 243600 | 243600 | KONFIRMUAR NGA ZRPP |
| 17 | MYRTEZA | XHEMAL | NOVI | 2174 | 39/2 | 781 | | 258600 | 258600 | KONFIRMUAR NGA ZRPP |
| 18 | NAZIF | SINAN | MIXHA | 2174 | 40/2 | 105 | 1300 | | 1300 | KONFIRMUAR NGA ZRPP |
| 19 | ASTRIT | NEVRUZ | VEIZI | 2174 | 40/5 | 524 | 9825 | | 9825 | KONFIRMUAR NGA ZRPP |
| 20 | SADIK | ETEM | HILA | 2174 | 40/4 | 321 | 18600 | | 18600 | KONFIRMUAR NGA ZRPP |
| | | TOTALI | | | | 11360 | 184590 | 502200 | 686790 | |

**VENDIM**
**Nr.1662, datë 24.12.2008**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.1586, DATË 3.12.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR TRANSFERIM FONDESH NGA BUXHETI I VITIT 2008, PËR MINISTRINË E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008", të ndryshuar, dhe të nenit 21 të ligjit nr.9640, datë 9.11.2006 "Për dhomat e tregtisë dhe industrisë", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Shkronja "a", e pikës 1, të vendimit nr.1586, datë 3.12.2008, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

"a) Në programin "Planifikim, menaxhim dhe administrim", zëri "Transferta korrente të brendshme", të shtohet fondi prej 16 000 000 (gjashtëmbëdhjetë milionë) lekësh, i cili të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**VENDIM**
**Nr.1670, datë 24.12.2008**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.638, DATË 18.9.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË INFERMIERISTIKËS, NË SISTEMIN E MINISTRISË SË SHËNDETËSISË", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat për caktimin e pagave të punës", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kreu 1.1 i lidhjes nr.1, "Struktura e pagave për punonjësit e infermieristikës në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë, Spitalin Universitar Obstetrik Gjinekologjik nr.1 e nr.2, Tiranë, Spitalin Universitar të Sëmundjeve të Mushkërive, "Shefqet Ndroqi", Tiranë, Klinikën Stomatologjike Universitare, Tiranë", që i bashkëlidhet vendimit nr.638, datë 18.9.2003, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, zëvendësohet me kreun me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efekti financiar, për paga e sigurime shoqërore, që rrjedh nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohet nga fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit të vitit 2009, për sistemin e Ministrisë së Shëndetësisë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2009.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

LIDHJA NR.1 (KREU 1.1)

STRUKTURA E PAGAVE PËR PUNONJËSIT E INFERMIERISTIKËS NË QENDRËN SPITALORE UNIVERSITARE "NËNË TEREZA" TIRANË, SPITALIN UNIVERSITAR OBSTETRIK GJINEKOLOGJIK NR.1, NR.2 TIRANË, SPITALIN E SËMUNDJEVE TË MUSHKËRISË "SHEFQET NDROQI" TIRANË, KLINIKËN STOMATOLOGJIKE UNIVERSITARE TIRANË

| | | **PAGA MUJORE** | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **PAGA INDIVIDUALE** | | | **SHTESA E POZICIONIT** | | |
| | **EMËRTIMI** | **Paga e grupit (PG)** | **Shtesa për vjetërsi (SHV)** | **Shtesa për kualifikim (SHK)** | **Shtesa për pozicion (SHP)** | **Shtesa për kushte punë (SHKP)** | **Totali** |
| | | **1** | **2** | **3** | **4** | **5** | |
| 1 | Shef i sektorit të kujdeseve infermierore | | 2% | 0 | 23 500 | 3600 | Nga..deri lekë |
| 2 | Kryeinfermier shërbimi psikiatrik | | 2% | 0 | 23 500 | 6000 | Nga..deri lekë |
| 3 | Kryeinfermier shërbimi në shërbimin infektiv në QSUT | | 2% | 0 | 23 500 | 8000 | Nga..deri lekë |
| 4 | Kryelaborant në shërbimin e anatomisë patologjike<br>Kryeinfermier shërbimi terapiseëintensive<br>Kryeinfermier shërbimi onkologjik<br>Kryelaborant rrezatim kobalti<br>Kryelaborant në histopatologji<br>Kryeinfermier të repartit të rrezatimit | | 2% | 0 | 23 500 | 3400 | Nga..deri lekë |
| 5 | Kryeinfermier reparti psikiatrik | | 2% | 0 | 23 500 | 5000 | Nga..deri lekë |
| 6 | Kryeinfermier reparti në shërbimin infektiv në QSUT | | 2% | 0 | 23 500 | 8000 | Nga..deri lekë |
| 7 | Kryeinfermier shërbimi Neurokirurgji<br>Kryemami e përgjithshme<br>Kryeinfermier/kryemami reparti i terapisë intensive | | 2% | 0 | 23 500 | 2600 | Nga..deri lekë |
| 8 | Kryeinfermier kimioterapi<br>Kryelaborant klinik biokimik<br>Kryeinfermier në urgjencën e sëmundjeve të brendshme<br>Kryeinfermier/ mami salle<br>Kryeinfermier/ mami e dhomës së zgjimit<br>Infermier në hemodinamikë<br>Kryelaborant imunolog, bakteriolog | | 2% | 0 | 23 500 | 1800 | Nga..deri lekë |
| 9 | Kryeinfermier shërbimi (kirurgji, neurologji (djegie, plastik, kardiokirurgji, maksilofacial, infektiv, pediatrik infektiv, obsetrik)<br>Kryeinfermier/kryemami në raportin e kirurgjisë<br>Kryemami turni në kirurgji<br>Kryemami turni në obsetrikë<br>Kryeinfermier reparti infektiv | | 2% | 0 | 23 500 | 1100 | Nga..deri lekë |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Kryeinfermier reparti (fizioterapi, urologji, urgjencës së neurologjisë, neurokirurgji onkologji)<br>Kryeinfermier/kryemami sallë operacioni | | | | | | |
| 10 | Kryeinfermier shërbimi<br>Kryelaborant shërbimi<br>Kryemami shërbimi | | 2% | 0 | 23 500 | | Nga..deri lekë |
| 11 | Infermier/laborant në psikiatri | | 2% | 0 | 22 000 | 5000 | Nga..deri lekë |
| 12 | Infermer në kyriterapi<br>Laborant histopatolog | | 2% | 0 | 22 000 | 3400 | Nga..deri lekë |
| 13 | Infermier/mami reanimacioni neonatologji<br>Infermier në dhomën e zgjimit | | 2% | 0 | 22 000 | 2650 | Nga..deri lekë |
| 14 | Infermier në kimioterapi | | 2% | 0 | 22 000 | 1800 | Nga..deri lekë |
| 15 | Kryelaborant radilogjie | | 2% | 0 | 22 000 | 1500 | Nga..deri lekë |
| 16 | Specialist i sektorit të kujdeseve infermierore<br>Kryeinfermier i edukimit shëndetësor TB | | 2% | 0 | 22 000 | 1100 | Nga..deri lekë |
| 17 | Kryeinfermier në repartin e alergologjisë<br>Kryeinfermier në sterilizim<br>Kryemami në izolim | | 2% | 0 | 22 000 | | Nga..deri lekë |
| 18 | Laborant radiolog në onkologji | | 2% | 0 | 20 500 | 3700 | Nga..deri lekë |
| 19 | Laborant rrezatim kobalti | | 2% | 0 | 20 500 | 3400 | Nga..deri lekë |
| 20 | Laborant në mjekësinë bërthamore | | 2% | 0 | 20 500 | 2650 | Nga..deri lekë |
| 21 | Infermier në njësinë e inspektoratit sanitar dhe infeksioneve nazokomiale<br>Infermier në sallën e operacionit | | 2% | 0 | 20 500 | 2100 | Nga..deri lekë |
| 22 | Kryeinfermier reparti pranim urgjence<br>Laborant klinik biokimik<br>Infermier në punktin e gjakut<br>Infermier në hematologji<br>Infermier në onkologji<br>Infermier endoskopie<br>Infermier/laborant bakterolog, imunolog | | 2% | 0 | 20 500 | 1800 | Nga..deri lekë |
| 23 | Infermier reparti radiolologjik<br>Laborant radiolog<br>Kryeinfermier (pranim urgjence, djegie plastike, kirurgji) | | 2% | 0 | 20 500 | 1500 | Nga..deri lekë |
| 24 | Infermier /mami (kirurgji, maksilofaciale, neurokirurgji, kardiokirurgji, djegie plastike, obstetrikë) | | 2% | 0 | 20 500 | 1100 | Nga..deri lekë |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Instrumentar | | | | | | |
| 25 | Kryeinfermier neonatologji<br>Kryemami në qendrën e gruas<br>Kryemami pranimi<br>Kryeinfermierë në kabinetin e dia1izës<br>Kryemami/kryeinfermier reparti<br>Kryeinfermier konsultash në sëmundjet e brendshme<br>Kryelaborant bakterolog, imunolog, ortopedi stomatologjike)<br>Infermier sterilizimi | | 2% | 0 | 20 500 | | Nga..deri lekë |
| 26 | Infermier pavioni rrezatimi | | 2% | 0 | 19 500 | 3310 | Nga..deri lekë |
| 27 | Infermier në shërbimin infektiv në QSUT | | 2% | 0 | 19 500 | 8000 | Nga..deri lekë |
| 28 | Infermier (infektiv, pranim urgjence, njësia e koordinimit të urgjencës) | | 2% | 0 | 19 500 | 1800 | Nga..deri lekë |
| 29 | Ndihmës farmacist<br>Infermier në hemodializë | | 2% | 0 | 19 500 | 1500 | Nga..deri lekë |
| 30 | Infermier fizioterapi | | 2% | 0 | 19 500 | 1100 | Nga..deri lekë |
| 31 | Laborant (ezhe, ortopedi, stomatologji)<br>Kryeinfermier çerdhe për personelin<br>Infermier<br>Infermier çerdhe për personelin<br>Kujdestar në pediatri | | 2% | 0 | 19 500 | | Nga..deri lekë |
| 32 | Kujdestar në psikiatri | | 2% | 0 | 17 000 | 5000 | Nga..deri lekë |

**VENDIM**
**Nr.1671, datë 24.12.2008**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR RRËSHEN-KALIMASH**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për

interes publik", dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Rrëshen-Kalimash.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

3. Pronarët e pasurisë së paluajtshme, (objekt), që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për objekt, me vlerë 3 125 158 (tre milionë e njëqind e njëzet e pesë mijë e njëqind e pesëdhjetë e tetë) lekë, dhe me vlerë 2 984 015 (dy milionë e nëntëqind e tetëdhjetë e katër mijë e pesëmbëdhjetë) lekë, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi 6 109 173 (gjashtë milionë e njëqind e nëntë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e tre) lekë.

4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 221 000 (dyqind e njëzet e një mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 6 109 173 (gjashtë milionë e njëqind e nëntë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e tre) lekë, të përballohet nga zëri "shpronësime", miratuar për Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

6. Shpronësimi të fillojë më 30.12.2008 dhe të përfundojë më 30.3.2009.

7. Pronarët, që shpronësohen, të kompensohen për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

8. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimin e pronarit, brenda afateve të përcaktuara në pikën 6 të këtij vendimi, sipas dokumentacionit të pronësisë dhe planimetrisë përkatëse.

9. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

LISTA E PRONAVE QË SHPRONËSOHEN SI REZULTAT I NDËRTIMIT TË SEGMENTIT RRUGOR RRËSHEN-KALIMASH

| | **PRONARI** | | **Z.K.** | **NR.PAS** | **OBJEKTI VLERA Lekë** | **SHËNIME** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Gjok | Ndue | Gega | 1190 | 27/7 | 3125158 | Konfirmuar nga ZRPP |
| Ndrec | Ndue | Gega | 1190 | 27/6 | 2984015 | Konfirmuar nga ZRPP |
| | Totali | | | | 6109173 | |

**VENDIM**
**Nr.1673, datë 24.12.2008**

**PËR CAKTIMIN E RREGULLAVE PËR SHITJEN E PASURIVE TË PERSONAVE JURIDIKË, JOBANKARË, QË KANË MARRË HUA NGA PUBLIKU I GJERË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 6, nënpika 6.2 e 11, të ligjit nr.8386, datë 30.7.1998 "Për mënyrën dhe procedurat e shitjes së pasurive të personave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shitja e objekteve, pasuri e personave, fizikë a juridikë, subjekte të ligjit nr.8227, datë 30.7.1997, si dhe e pasurive të ish-presidentëve e të pjesëtarëve të familjeve të tyre dhe të personave të tjerë, të deklaruar të lidhur me ta, bëhet në lekë dhe në valutë të huaj.

Komisioni i ankandit, për shitjen e pasurive, nuk do të pranojë shkëmbimin e vlerës së pasurive, me atë, që rezulton nga kontrata e huadhënies së lidhur, nëpërmjet subjektit të kontrollit dhe kreditorëve të tyre.

2. Shitja e pasurive të personave, juridikë dhe fizikë, sipas pikës 1 të këtij vendimi, realizohet nga Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, në bashkëpunim me administratorët e shoqërive huamarrëse, nëpërmjet ankandit, duke pasur parasysh kriteret e vendosura në ligjin nr.8386, datë 30.7.1998 "Për mënyrën dhe procedurat e shitjes së pasurive të personave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë", të ndryshuar.

3. Administratori, para se të fillojë procedura e publikimit të asetit në ankand, kryen këto detyra:

a) Saktëson, me konsulentët juridikë, pronësinë e pasurisë, që do të shitet.

b) Cakton grupin e vlerësimit të pasurisë për çdo element të veçantë të pasurisë, që do të shitet. Ky grup, i përbërë nga ekspertë të fushës përkatëse, teknike dhe ekonomike, përgatit raportin e vlerësimit sipas legjislacionit në fuqi dhe metodologjisë e standardeve ndërkombëtare, që zbatohen në këtë fushë, duke përcaktuar vlerën reale të tregut.

c) Ruan raportin e vlerësimit, ku është i përcaktuar çmimi nga ekspertët vlerësues të licencuar të fushës përkatëse, teknike dhe ekonomike, të autorizuar, i cili për shkak të karakterit konfidencial, nuk përfshihet në dosjen e asetit dhe nuk publikohet. Ky raport publikohet nga administratori vetëm kur hapet ankandi.

4. Komisioni i ankandit përbëhet nga këto anëtarë:

a) Me të drejtë vote:

i) përfaqësuesi i Ministrisë së Financave (DASHPP) kryetar;

ii) administratori i shoqërisë huamarrëse anëtar;

iii) juristi i shoqërisë huamarrëse anëtar.

b) Pa të drejtë vote:

i) sekretari, punonjësi i DASHPP-së, (i cili mban procesverbalin e ankandit);

ii) të ftuar të përhershëm, anëtarët e Grupit Mbikëqyrës të Shoqërive Huamarrëse (me statusin e vëzhguesit).

Emrat e anëtarëve të komisionit shpallen me vendim të veçantë të drejtorit të DASHPP-së dhe të përfaqësuesit të Grupit Mbikëqyrës të Shoqërive Huamarrëse.

Pjesëmarrja në ankand në datën dhe orën e caktuar është e detyrueshme, për të gjithë anëtarët e komisionit.

5. Komisioni i ankandit ka këto detyra:

a) Merr pjesë në ankand në datën dhe orën e caktuar;

b) Regjistron dhe verifikon për të gjithë pjesëmarrësit në ankand:

- dokumentacionin e personave juridikë;
- identitetin e personave fizikë, sipas dokumentacionit identifikues si: pasaportë, letërnjoftim ose certifikatë;
- prokurat e veçanta të përfaqësimit të tyre.

c) Drejton marrjen e ofertave;

ç) Siguron se dhënia e ofertave do të vazhdojë deri në datën dhe orën e caktuar të ankandit;

d) Verifikon në shoqëritë huamarrëse, nëse personat, që marrin pjesë në ankand, janë ose jo kreditorë të ndonjë subjekti kontrolli, sipas ligjit;

dh) Nënshkruan procesverbalin e ankandit.

6. Pjesëmarrësit në ankand duhet të paraqesin në datën dhe orën e caktuar, pranë komisionit të ankandit, këtë dokumentacion:

a) Formularin e plotësuar me ofertën për asetin, që ata do të blejnë;

b) Mandatin ose dokumentacionin bankar, i cili vërteton shumën e depozitës për blerjen e pasurive, që do të shiten;

c) Deklaratën me shkrim për llogarinë bankare, që disponon, apo sasinë e mjeteve monetare, *cash;*

ç) Dokumentin e depozitimit, nga çdo pjesëmarrës, të së paku 20 për qind të shumës, për të cilin ai konkurron, në lekë ose valutë të huaj, në llogarinë e shoqërisë huamarrëse përkatëse, në bazë të kushteve të shitjes, të përcaktuara në katalog dhe të pranuara nga ai vetë.

Banka kryen vetëm depozitimin e shumës, pa kërkuar të dhëna të tjera.

7. Publikimi i shitjes së aseteve të shoqërive huamarrëse do të kryhet nga DASHPP-ja, në Ministrinë e Financave, e cila harton edhe katalogun e shitjes.

Procedurat e publikimit të ankandit për shitjen e pasurive të shoqërive huamarrëse dhe të personave të deklaruar të lidhur me ta fillojnë, pasi administratori të ketë plotësuar dosjen e pasurisë, që do të shitet, të pranuar nga DASHPP-ja.

Periudha e publikimit zgjat 21 ditë nga data e botimit të parë, në çdo Buletin të Njoftimeve Publike, brenda këtij afati. Ky njoftim botohet edhe në dy gazeta me qarkullim të madh kombëtar.

Publikimi i spoteve dhe i emisioneve të procesit të shitjes bëhet në mediat audiovizive.

Njoftimi për publikim duhet të përcaktojë:

a) vendin, datën dhe orën e zhvillimit të ankandit;

b) emërtimin dhe vendndodhjen e objektit, që do të shitet;

c) të dhënat e hollësishme, të fiksuara në katalogun e objektit.

8. Pjesëmarrësit në ankand, pas blerjes së katalogut pranë DASHPP-së, kanë të drejtë të studiojnë dokumentacionin, që ndodhet në dosjen e objektit, me përjashtim të dokumentacionit të vlerësimit të tij.

9. Ankandi i shitjes zhvillohet në mjediset e DASHPP-së, në qytetin e Tiranës. Ofertat e paraqitura pranohen gjatë të gjitha ditëve të javës, me zarfe të mbyllura, të noterizuara nga noteri. Pasi protokollohen nga sekretarja e komisionit, vendosen nga vetë ofertuesit, në kutinë e pranimit të ofertave, e cila është e kyçur, e vulosur, dhe mbahet nga sekretarja e komisionit të ankandit.

Në të gjitha rastet, pasuritë e shoqërive huamarrëse në administrim nuk lejohen të shiten nën çmimin e raportit të vlerësimit, të përcaktuar nga ekspertët vlerësues.

10. Fitues i ankandit shpallet pjesëmarrësi, që ofron çmimin më të lartë, me përjashtim të rastit të përcaktuar në pikën 12 të këtij vendimi.

Pjesëmarrësve të tjerë u kthehet 20 për qind e shumës së paguar paraprakisht për konkurrimin në ankand.

11. Nëse aseti nuk shitet pas zhvillimit, tri herë radhazi të ankandit, atëherë DASHPP-ja, në bashkëpunim me administratorin e shoqërisë huamarrëse, marrin vendim, për të bërë rivlerësimin e asetit nga grupi i ekspertëve vlerësues.

12. Kreditori ka të drejtë të futet si blerës i parë për pasuritë e shoqërisë huamarrëse, ku ai ka depozituar vlerat e tij financiare, kur ndërmjet një a më shumë kërkuesve, pjesëmarrës në ankand, janë ofruar çmime të barabarta blerjeje. Në këtë rast, kreditori paraqet kërkesën për blerje të pasurisë, sipas të gjitha rregullave dhe procedurave të caktuara në këtë vendim. Kur komisioni i ankandit vëren se ofertat e paraqitura për çmimin e blerjes së pasurive janë të njëjta me ato të kreditorit apo të një grupi të kreditorëve, shpall fitues kreditorin, që ka paraqitur kërkesën për blerjen e pasurisë.

13. Personi, fizik a juridik, që shpallet fitues i ankandit, duhet të paguajë çmimin e plotë të blerjes, nëpërmjet bankës, në llogarinë e shoqërisë huamarrëse përkatëse. Në rast se fituesi i ankandit, brenda 30 ditëve nga data e shpalljes fitues, nuk paguan vlerën e plotë të pasurisë, që shitet, ai e humbet të drejtën e blerjes. Vlera 20 për qind, e paguar paraprakisht, nuk kthehet. Objekti apo pasuria

rishpallet për shitje, duke zbatuar procedurat e publikimit nga e para.

14. Në rastet kur shoqëritë huamarrëse në administrim kanë në pronësi aksione ose forma të tjera interesi me shoqëritë apo individë të tjerë, administratori i kërkon ortakut dokumentacionin e plotë të shoqërisë së përbashkët, deklarimin e vlerës së kapitalit të investuar, vlerat e fituara nga ortakëria, shpenzimet dhe interesat e paguara nga koha e krijimit të shoqërisë, të cilat i paraqiten komisionit të ankandit. Komisioni i ankandit ia ofron fillimisht pjesën në pronësi të shoqërisë huamarrëse, për blerje të drejtpërdrejtë, ortakut. Në rast se oferta e paraqitur nga ortaku nuk plotëson kërkesat e caktuara, atëherë pjesa në pronësi të shoqërisë në administrim shitet në ankand.

15. Përjashtimet nga e drejta e blerjes e kategorisë së personave, në kuptim të nenit 8 të ligjit nr.8386, datë 30.7.1998, verifikohen dhe kontrollohen nga grupi i ekspertëve financiarë, nëpërmjet konsulentëve juridikë, të caktuar nga grupi i mbikëqyrjes i shoqërive huamarrëse.

Kur konstatohen veprime në kundërshtim me ligjin dhe pasuritë blihen nga kategoria e personave të përjashtuar apo persona të tretë, të autorizuar nga ana e tyre, pasuritë rivihen në shitje dhe vlerat e shitjes së tyre, nuk i rikthehen blerësit, por kalojnë në favor të kreditorëve.

16. Të drejtat dhe detyrimet e palëve në procesin e shitjes së pasurive të shoqërive huamarrëse realizohen nëpërmjet kontratës, që DASHPP-ja dhe administratori i shoqërisë huamarrëse lidhin me blerësin.

17. Procesi i shitjes së pasurive të shoqërive huamarrëse kontrollohet nga ekspertë kontabël, vendas e të huaj, si dhe mbikëqyret, në të gjitha etapat, nga Grupi i Mbikëqyrjes i Shoqërive Huamarrëse.

18. Vendimi nr.493, datë 13.8.1998 i Këshillit të Ministrave "Për caktimin e rregullave për shitjen e pasurive të personave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë", dhe aktet e tjera, dalë në zbatim të tij, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**VENDIM**
**Nr.1675, datë 24.12.2008**

## PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.84, DATË 3.2.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR KALIMASH-MORINË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", dhe të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 3 të vendimit nr.84, datë 3.2.2008 të Këshillit të Ministrave bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Ndryshimet

i) Sipërfaqja tokë arë nga "351 569 (treqind e pesëdhjetë e një mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) $m^2$" bëhet "342 455 (treqind e dyzet e dy mijë e katërqind e pesëdhjetë e pesë) $m^2$ ";

ii) Vlera e tokës arë nga "160 173 400 (njëqind e gjashtëdhjetë milionë e njëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e katërqind) lekë" bëhet "155 616 400 (njëqind e pesëdhjetë e pesë milionë e gjashtëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e katërqind) lekë";

iii) Sipërfaqja tokë truall nga "12 229 (dymbëdhjetë mijë e dyqind e njëzet e nëntë) $m^2$" bëhet "17 209 (shtatëmbëdhjetë mijë e dyqind e nëntë) $m^2$".

iv) Vlera e tokës truall nga "19 087 730 (nëntëmbëdhjetë milionë e tetëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e tridhjetë) lekë", bëhet "46 522 550 (dyzet e gjashtë milionë e pesëqind e njëzet e dy mijë e pesëqind e pesëdhjetë) lekë";

v) Vlera e përgjithshme e shpronësimit nga "281 775 816.7 (dyqind e tetëdhjetë e një milionë e shtatëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e gjashtëmbëdhjetë pikë shtatë) lekë" bëhet "304 653 636.7 (treqind e katër milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tre mijë e gjashtëqind e tridhjetë e gjashtë pikë shtatë) lekë".

b) Shtesat

i) Shtohet sipërfaqja truall, 883 (tetëqind e tetëdhjetë tre) $m^2$, vlerësuar me çmimin 1350 (një mijë e treqind e pesëdhjetë) lekë/$m^2$, me vlerë 1 124 550 (një milion e njëqind e njëzet e katër mijë e pesëqind e pesëdhjetë) lekë;

ii) Shtohet objekti, me vlerë 14 325 740 (katërmbëdhjetë milionë e treqind e njëzet e pesë mijë e shtatëqind e dyzet) lekë, në pronësi të Bedri Hamit Shehut, me vlerë totale 15 450 290 (pesëmbëdhjetë milionë e katërqind e pesëdhjetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë) lekë.

2. Në listën e lagjes Drinas, që i bashkëlidhet vendimit në fuqi ndryshojnë pronarët për pasuritë, si më poshtë vijon:

i) nr.157/4 nga "Tahir Zenel Oruçi" në "Habibe Ahmet Oruçi";

ii) nr.157/5 nga "Qemal Zenel Oruçi" në "Tahir Zenel Oruçi";

iii) nr.157/1 dhe nr.157/2 nga "Petrit Rasim Oruçi" në "Qemal Zejnel Oruçi";

iv) nr.157/3 nga "Habibe Ahmet Oruçi", në "Qemal Zejnel Oruçi".

Ndryshimet të bëhen sipas listës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Pronarët e lagjes Drinas, Kukës të kompensohen për diferencën e konvertimit në truall të sipërfaqes së shpronësuar dhe për sipërfaqen tokë arë, sipas masës përkatëse të kompensimit, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Totali i diferencës së konvertimit, prej 25 283 320 (njëzet e pesë milionë e dyqind e tetëdhjetë e tre mijë e treqind e njëzet) lekësh, dhe shtesa e shpronësimit, prej 15 450 290 (pesëmbëdhjetë milionë e katërqind e pesëdhjetë mijë e dyqind e nëntëdhjetë) lekësh, me një vlerë të përgjithshme, prej 40 733 610 (dyzet milionë e shtatëqind e tridhjetë e tre mijë e gjashtëqind e dhjetë) lekësh, të përballohen nga zëri "Shpronësime", miratuar për Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

5. Likuidimi dhe shpronësimi shtesë të fillojnë më 30.12.2008 dhe të përfundojë më 30.3.2009.

6. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi "Konfirmim nga ZRPP-ja", të kompensohen për diferencën përkatëse të konvertimit të tokës në truall dhe të shpronësohen, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

7. Pronari Bedri Hamit Shehu, që shpronësohet për pikë karburanti, të kompensohet, për efekt shpronësimi, pasi të ketë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë dhe dokumentacionin e plotë tekniko-ligjor të pikës së karburantit.

8. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të bëjë likuidimin e pronarëve, brenda afateve të përcaktuara në pikën 4 të këtij vendimi.

9. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të likuidojë pronarin Bedri Hamit Shehu për pikën e karburantit, në bazë të dokumentacionit ligjor të pronësisë dhe në bazë të dokumentacionit tekniko-ligjor të kësaj pike karburanti.

10. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

10978

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
QARKU: KUKËS
Bashkia: KUKËS

LISTA E PRONARËVE QË PREKEN NGA KORRIDORI DURRËS – MORINË (SEKSIONI KALIMASH – MORINË )
Lloji i pasurisë së patundshme: tokë are, truall

| Nr. | Pronari | | | VKM nr.84, datë 3.2.2008 | | | | Pronari sipas ZRPP-së | | | Nr. pas. | Lloji pas | Ndryshimi sipas ZRPP-së | | | Diferenca e llogaritur për likuidim | Objekt Vlera lekë | Shënime |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Emri | Atësia | Mbiemri | Nr. pas. | Sip. $m^2$ Arë | Çmim $m^2$ | Vlera lekë | Emri | Atësia | Mbiemri | | | Sip. $m^2$ | Çmim $m^2$ | Vlera lekë | | | |
| | Lagjia Drinas Zk 1513 | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 1. | Zyber | Sali | Estrefi | 5912 | 1410 | 500 | 705000 | Shtet | | | 59/2 | Truall | | | | | | Konfirmuar nga ZRPP |
| 2. | Petrit | Rasim | Oruci | 157I1 | 1343 | 500 | 671500 | Qemal | Zejnel | Oruçi | 157/1 | Are | 420 | 500 | 210000 | | | Konfirmuar nga ZRPP |
| 3. | Petrit | Rasim | Oruçi | 157/2 | 1460 | 500 | 730000 | Qemal | Zejnel | Oruci | 157/2 | Are | 923 | 500 | 461500 | | | Konfirmuar nga ZRPP |
| 4. | Habibe | Ahmet | Oruci | 157/3 | 1229 | 500 | 614500 | Qemal | Zejnel | Oruçi | 157/3 | Are | 838 | 500 | 419000 | | | Konfirmuar nga ZRPP |
| 5. | Tahir | Zenel | Oruci | 157/4 | 700 | 500 | 350000 | Habibe | Ahmet | Oruci | 157/4 | Truall | 967 | 5509 | 5327203 | 4977203 | | Konfirmuar nga ZRPP |
| 6. | Qemal | Zene | Oruci | 157/5 | 55 | 500 | 27500 | Tahir | Zejnel | Oruçi | 157/5 | Truall | 700 | 5509 | 3856300 | 3828800 | | Konfirmuar nga ZRPP |
| 7. | Gezim | Zenel | Oruçi | 157/6 | 597 | 500 | 298500 | Gezim | Zejnel | Oruci | 157/6 | Truall | 597 | 5509 | 3288873 | 2990373 | | Konfirmuar nga ZRPP |
| 8. | Feride | Rahim | Crud | 186 | 1463 | 500 | 731500 | Feride | Rrahman | Oruçi | 186 | Truall | 1228 | 5509 | 6765052 | 6033552 | | Konfirmuar nga ZRPP |
| 9. | Tahir | Zenel | Oruçi | 187 | 888 | 500 | 444000 | Tahir | Zejnel | Oruci | 187 | Truall | 888 | 5509 | 4891992 | 4447992 | | Konfirmuar nga ZRPP |
| 10 | Qemal | Sinan | Mehmeti | 188/1 | 500 | 500 | 250000 | Qemal | Sinan | Mehmetaj | 188/1 | Truall | 500 | 5509 | 2754500 | 2504500 | | Konfirmuar nga ZRPP |
| 11. | Sadik | Shahip | Dulla | | 100 | 500 | 50000 | Sadik | Shaip | Dulla | 192/8 | Truall | 100 | 5509 | 550900 | 500900 | | Konfirmuar nga ZRPP |
| 12. | Rasim | Halil | Oruçi | | 252 | 500 | 126000 | | | | | | | | | | | Rasim Halil Oruçi, nuk figuron pronar sipas ZRPP-se |
| 13. | Abedin | Rasim | Oruçi | 211/5 | 148 | 500 | 74000 | Shtet | | | 211/5 | Truall | | | | | | Pronari Abedin Oruçi është konfirmuar vetëm për ndërtesë dhe jo për truall |
| 14. | I paidentfikuar | | | | 315 | 500 | 157500 | | | | | | | | | | | Nuk ekziston |
| 15. | Sinan | Hamz | Mehmeti | 165/2 | 835 | 500 | 417500 | Sinan | Hamz | Mehmeti | 165/2 | ND | | | | | | Ky pronar është konfirmuar vetëm për ndërtesë dhe jo përtruall |
| | | | | | 11295 | | 5647500 | | | | | | 4980 | | 27434820 | 25283320 | | |
| | Fshati Shtiqen ZK. 3425 | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 1. | | | | | | | | Bedri | Ahmet | Shehu | 107/4/1 | Truall | 833 | 1350 | 1124550 | 1124550 | 14325740 | Konfitmuar nga ZRPP |
| | | Totali | | | | | | | | | | | 5813 | | | | 40733610 | |

**VENDIM**
**Nr.1676, datë 24.12.2008**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR RRETHRROTULLIMI, LEZHE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik" dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor rrethrrotullimi, Lezhë.
2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqet 827 (tetëqind e njëzet e shtatë) $m^2$, tokë truall, e 646 (gjashtëqind e dyzet e gjashtë) $m^2$, tokë arë, me vlerë të përgjithshme 2 409 528 (dy milionë e katërqind e nëntë mijë e pesëqind e njëzet e tetë) lekë.
4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 221 000 (dyqind e njëzet e një mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.
5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 2 409 528 (dy milionë e katërqind e nëntë mijë e pesëqind e njëzet e tetë) lekë, të përballohet nga buxheti i vitit 2008, zëri "Shpronësime", miratuar për Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.
6. Shpronësimi të fillojë më 30.12.2008 dhe të përfundojë më 30.3.2009.
7. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi "Konfirmim ZRPP", të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
8. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë verifikimet për përputhshmërinë e sipërfaqeve, të cilat preken, me numrat e pasurive, në pronësi të pronarëve, që shpronësohen.
9. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I OBJEKTIT "PËRMIRËSIMI I SIGURISË RRUGORE RRETHRROTULLIMI LEZHË"

| Nr. | Emri | Atësia | Mbiemri | Z.K. | Nr. pasurisë | Lloji i Pasurisë | | | | | | Vlera totale (lekë) | Shënime |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Arë | | | Truall | | | | |
| | | | | | | Sip. | Çmimi | Vlera | Sip | Çmimi | Vlera | | |
| 1. | Shoq. "Autogrill Vilson" sh.a. | | | 1987 | 180/98 | | 428 | 0 | 306 | 3182 | 973692 | 973692 | Konfirm. nga ZVRPP |
| 2. | Ilir | Ramazan | Gjoçi | 1987 | 180/44 | 115 | 428 | 49220 | | 3182 | 0 | 49220 | Konfirm. nga ZVRPP |
| 3. | Fatmir | Hakik | Hoti | 1987 | 104/28 | 90 | 428 | 38520 | | 3182 | 0 | 38520 | Konfirm. nga ZVRPP |
| 4. | Bibe | Preng | Frroku | 1987 | 180/36 | | 428 | 0 | 340 | 3182 | 1081880 | 1081880 | Konfirm. nga ZVRPP |
| 5. | Mark | Gjok | Ivanaj | 1987 | 104/27 | 87 | 428 | 37236 | | 3182 | 0 | 37236 | Konfirm. nga ZVRPP |
| 6. | Gjok | Ded | Deda | 1987 | 104/15 | 398 | 428 | 170344 | | 3182 | 0 | 170344 | Konfirm. nga ZVRPP |
| 7. | Bibe | Simon | Nikolla | 1987 | 104/3 | 137 | 428 | 58636 | | 3182 | 0 | 58636 | Konfirm. nga ZVRPP |
| | | | | | | | | 353956 | | | 2055572 | 2409528 | |

**VENDIM**
**Nr.1677, datë 24.12.2008**

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA NDËRTIMI I STACIONIT TË POMPIMIT, TUSHEMISHT, POGRADEC**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik" dhe të nenit 8 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006", me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga ndërtimi i stacionit të pompimit, Tushemisht, Pogradec.
2. Shpronësimi të bëhet në favor të ujësjellës-kanalizimeve, sh.a.-së Pogradec.
3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 100 (njëqind) $m^2$, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi 62 490 (gjashtëdhjetë e dy mijë e katërqind e nëntëdhjetë) lekë.
4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 221 000 (dyqind e njëzet e një mijë) lekë, të përballohen nga ujësjellës-kanalizime, sh.a. Pogradec.
5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 62 490 (gjashtëdhjetë e dy mijë e katërqind e nëntëdhjetë) lekë, të përballohet nga llogaria e veçantë e Ministrisë së Financave në Bankën e Shqipërisë, "Fondi i shpronësimeve".
6. Shpronësimi të fillojë më 25.12.2008 dhe të përfundojë më 30.1.2009.
7. Pronari të kompensohet, për efekt shpronësimi, pasi të ketë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë ujësjellës-kanalizimeve, sh.a., Pogradec.
8. Ujësjellës-kanalizime, sh.a. Pogradec, të kryejë verifikimet për përputhshmërinë e sipërfaqes, që preket me numrin e pasurisë në pronësi të pronarit, që shpronësohet.
9. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe ujësjellës-kanalizime, sh.a. Pogradec, për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN SI REZULTAT I NDËRTIMIT TË STACIONIT TË POMPIMIT,TUSHEMISHT, POGRADEC

| Nr. | Emri | Atësia | Mbiemri | Zona kad. | Nr.pas | Lloji pas. | Sip m2 | Çmimi m2/lekë | Vlera (lekë) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Hil | Ndoc | Hila | 3664 | 4/8 | Tokë arë | 100 | 624.9 | 62 490 |

**VENDIM**
**Nr.1679, datë 24.12.2008**

## PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E PËRCAKTIMIT TË STATUSIT TË ORGANIZATAVE JOFITIMPRURËSE, PËR PËRFITIM PUBLIK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të paragrafit të dytë të nenit 24 të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Një organizatë jofitimprurëse (OJF) mund të kërkojë statusin e përfitimit publik, në qoftë se plotëson kriteret e mëposhtme:

1.1. Është e organizuar dhe e strukturuar për kryerjen e një ose më shumë veprimtarive në arsim dhe shëndetësi, si veprimtari kryesore të saj. Arsimi dhe shëndetësia janë veprimtari të përfitimit publik vetëm nëse ofrojnë, për grupe ose persona në nevojë, shërbime të rëndësishme, falas ose me çmim më të ulët se vlera e tregut. Zhvillimi ekonomik përbën veprimtari të përfitimit publik vetëm nëse ndërmerret, kryesisht, në përfitim të grupeve ose personave në nevojë.

1.2. Çmimet e mallrave dhe të shërbimeve, që ato furnizojnë, janë jo më pak se 50 për qind më të ulëta se çmimet e tregut të zonës, ku ofrohet malli/shërbimi, ose kur i ofrojnë këto shërbime a mallra falas.

Vlera e tregut përcaktohet në bazë të metodave të përcaktuara në udhëzimin nr.24, datë 2.9.2008 të Ministrit të Financave "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë".

1.3. Të ardhurat nga furnizimi i mallrave dhe shërbimeve mbulojnë, minimalisht, jo më shumë se 50 për qind të kostos së ofrimit të mallit/shërbimit dhe pjesa tjetër duhet të mbulohet nga donacionet, kontributet dhe të ardhura të tjera të OJF-së.

2. Nëse vërehen shkelje nga OJF-ja, të këtij vendimi, Ministri i Financave revokon ose pezullon autorizimin për statusin e përfitimit publik. Në rast revokimi ose pezullimi të statusit të përfitimit publik duhet të respektohen dispozitat përkatëse të pikës 4 të këtij vendimi.

3. Organizatat jofitimprurëse, të interesuara për të përfituar statusin e OJF-së për përfitim publik, duhet të paraqesin një kërkesë me shkrim pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, së bashku me dokumentet e mëposhtme:

a) Certifikatën tatimore, NIPT-in (fotokopje e noterizuar);

b) Vendimin e gjykatës (fotokopje e noterizuar);

c) Statutin e organizatës jofitimprurëse dhe kontratën e themelimit (për personat juridikë);

ç) Dokumentet nga gjykata, prokuroria, si për shoqatën edhe për administratorin, dëshminë për mosndjekje penale nga Ministria e Drejtësisë;

d) Vërtetimin nga zyra e përmbarimit se ndaj subjektit nuk ka nisur procedurë falimentimi;

dh) Një deklaratë për misionin dhe qëllimin mirëbërës shoqëror të OJF-së;

e) Identifikimin e programeve kryesore dhe të veprimtarive, që kanë për qëllim realizimin e programeve. Deklarata duhet të dëshmojë mënyrën si organizata realizon qëllimet mirëbërëse shoqërore, përmes veprimtarive;

ë) Një deklaratë për arritjet kryesore të programeve;

f) Vërtetimin se nuk ka mbledhur fonde dhe nuk ka bërë fushatë për përkrahjen e partive politike apo për emërimin e zgjedhjen e kandidatëve në detyra të ndryshme publike, apo për regjistrimin dhe përkrahjen e kandidatëve të emëruar a të zgjedhur në funksione publike gjatë periudhës, për të cilën raportohet;

g) Nëse është e angazhuar në veprimtari mirëbërëse shoqërore, në fushën e arsimit apo të shëndetësisë, një deklaratë për:

i) kategorinë e personave dhe të grupeve të varfra, të cilëve u shërben;

ii) kategorinë e dobive, që u ofron personave dhe grupeve të njerëzve të varfër;

iii) një vërtetim se mallrat apo shërbimet ofrohen falas apo u ofrohen, së paku, 50 për qind më lirë se vlera e tyre në treg;

gj) OJF-ja, e cila angazhohet në veprimtari bamirëse shoqërore, në fushën e zhvillimit ekonomik, dorëzon edhe një deklaratë për kategorinë e personave të varfër apo të grupeve, që u shërben;

h) Deklaratat financiare, të cilat duhet të përmbajnë:

i) bilancin. Nëse OJF-ja ka tri ose më shumë se tri vite që është krijuar, paraqitet bilanci i tri viteve të fundit, vërtetuar nga eksperti kontabël;

ii) burimet e financimit.

Një OJF mund të kërkojë të aplikojë për statusin për përfitim publik në çastin kur bën regjistrimin fillestar si OJF ose edhe më vonë.

3.1 Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve ngre një grup pune (me 2 deri 3 punonjës), i cili verifikon tërë veprimtarinë e organizatës jofitimprurëse, në përputhje me kriteret e përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, si dhe bën verifikimet e nevojshme për borxhet e mundshme dhe shkeljet e mundshme të organizatës.

3.2 Në përfundim të këtij verifikimi, grupi i punës harton një raport për drejtorin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, ku përshkruhen edhe sugjerimet e mundshme për dhënien e autorizimit.

3.3. Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve përcjell te Ministri i Financave brenda dy javëve nga data e dorëzimit të kërkesës, kërkesën, me dokumentet shoqëruese mendimin e vet, për miratimin e autorizimit.

3.4 Ministri i Financave, brenda shtatë ditëve, miraton lëshimin e autorizimit për OJF-të, që plotësojnë kriteret e përcaktuara në këtë vendim. Autorizimi është i vlefshëm për 3 vjet, me të drejtë rinovimi.

Nëse dhënia e autorizimit refuzohet, Ministri i Financave jep arsyet, për të cilat autorizimi është refuzuar.

4. Ministri i Financave pezullon ose revokon një autorizim për shkelje të ndonjë dispozite të këtij vendimi. Përveç rasteve të shkeljeve serioze, që rrezikojnë apo dëmtojnë publikun, Ministri i Financave i dërgon OJF-së njoftim me shkrim për shkeljen e dispozitave dhe i jep mundësi për t'u përgjigjur para se të pezullojë ose revokojë autorizimin. Rastet e pezullimit dhe të revokimit të autorizimit përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.

4.1 Nëse gjatë kontrolleve të organeve tatimore vërehet se OJF-ja kryen veprimtari apo furnizon mallra a shërbime në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në pikat 1 e 2 të këtij vendimi, me propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, Ministri i Financave ka të drejtë t'ia heqë ose pezullojë OJF-së të drejtën e përjashtimit nga TVSH-ja. Në këtë rast, OJF-ja detyrohet të paguajë detyrimin e papaguar pas vlerësimit tatimor. Nëse pas heqjes të së drejtës për të përfituar përjashtim nga TVSH-ja, organizata jofitimprurëse rikthehet në situatën e mëparshme, ajo ka të drejtë të fillojë aplikimin për autorizim nga e para.

4.2 Organet doganore ruajnë të drejtën për t'i kontrolluar ngarkesat apo dërgesat për OJF-të me status të përfitimit publik. Mallrat e padeklaruara apo të deklaruara në mënyrë të rreme (përfshirë deklaratat mashtruese për vlerën e mallit) do të tatohen dhe trajtohen si shkelje doganore. Organet doganore vënë në dijeni Ministrinë e Financave për çfarëdo shkelje ligjore. Organet doganore ruajnë të drejtën të bëjnë verifikime të mëvonshme për destinimin dhe përdorimin e ngarkesave e të dërgesave, të liruara nga OJF-të me status të përfitimit publik. Nëse kontrollimet e mëvonshme tregojnë se ka pasur mashtrim apo shkelje doganore, OJF-ja detyrohet ta paguajë TVSH-në sikur ato mallra të ishin importuar në mënyrë tregtare dhe, veç të tjerash, i duhet të paguajë edhe dënimet, për shkeljet doganore.

5. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për zbatimin e këtij vendimi.

6. Ngarkohet Ministri i Financave për nxjerrjen e udhëzimit, në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

**UDHËZIM**
**Nr.17/4, datë 26.12.2008**

## PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.17, DATË 13.5.2008 "PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR"

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", i ndryshuar, Ministri i

Financave,

UDHËZON:

Në udhëzimin nr.17, datë 13.5.2008 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1.1 "Detyrimi për të kërkuar regjistrimin", shfuqizohet dhe, zëvendësohet me pikën 1.1 të formuluar si më poshtë:

"1.1 Detyrimi për të kërkuar regjistrimin

a) çdo person fizik apo juridik që zhvillon veprimtari ekonomike, qarkullimi i të cilit tejkalon apo parashikohet të tejkalojë 8 milionë lekë për një vit kalendarik, si dhe importues, detyrohet të kërkojë të regjistrohet.

Termi "person" përfshin çdo subjekt që kryen një veprimtari ekonomike, pavarësisht nga forma juridike e organizimit të tij. Ai përfshin edhe institucionet, organet e pushtetit qendror e vendor, organizatat shoqërore e politike që kryejnë veprimtari ekonomike të tatueshme.

Janë të detyruar të regjistrohen gjithashtu edhe çdo subjekt tjetër si individët, organet e pushtetit qendror e lokal, organizatat shoqërore, politike, ndërkombëtare, misionet diplomatike etj. që kryejnë importe, pavarësisht nga qarkullimi.

b) Përjashtohen nga ky rregull dhe lejohen të kryejnë veprime në organet doganore:

- Tatimpaguesit që ushtrojnë veprimtari ekonomike eksportuese. Këta persona, pavarësisht mënyrës së tyre të regjistrimit (tatimpagues të TVSH-së, apo tatimpagues të taksave vendore), mund të bëjnë veprime doganore.

- Tatimpaguesit importues, që kanë vendndodhje të biznesit në Malësinë e Madhe, Sarandë, si dhe që realizojnë një qarkullim më të vogël se 8 milionë lekë në çdo vit kalendarik.

- Tatimpaguesit, që janë subjekt i ligjit "Për taksën vendore të biznesit të vogël", që importojnë mallra në funksion të veprimtarisë ekonomike të personit që i ka importuar. Këto janë mallra të grupit të AQT dhe konkretisht si të tilla përmenden:

- makineri-pajisje pune;
- instalime teknike;
- makineri e pajisje energjetike;
- instrumente e vegla;
- mjete transporti;
- mobilie e orendi zyrash;
- pajisje zyrash e informatike.

Kjo kategori e tatimpaguesve mund të importojë vetëm duke qenë e regjistruar si paguese e taksës vendore të biznesit të vogël.

c) Për çdo subjekt që kryen import-eksporte, veprimet doganore bëhen vetëm pasi ai të ketë paraqitur origjinalin ose kopjen e noterizuar të certifikatës së numrit të identifikimit për personin e tatueshëm (NIPT).

ç) Mund të bëjnë veprime doganore, pa qenë të detyruar të regjistrohen, vetëm individët për mallrat e përdorimit personal. Përcaktimi "mallra të përdorimit personal" bëhet në përputhje me dispozitat e nenit 199 të Kodit Doganor dhe të pikës 2.12 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.205, datë 13.4.1999 "Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor", i ndryshuar. Nuk janë të detyruar të regjistrohen gjithashtu individët që kryejnë importe të rastësishme, si mjete transporti për përdorim privat, dhe të tjera të kësaj natyre, pavarësisht se për importet e mësipërme ato janë të detyruar të paguajnë tatim mbi vlerën e shtuar në doganë. Në këtë rast, importimi bëhet me një NIPT të përbashkët, i cili akordohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe u bëhet i ditur të gjitha pikave doganore nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

2. Në fund të pikës 8.1.1 "Vlera minimale e tatueshme e ndërtimit të banesave", shtohen paragrafët me këtë përmbajtje:

"Përcaktimi i kostos reale për efekt të llogaritjes së detyrimeve tatimore në sektorin e ndërtimit, të investimeve private apo publike, do të përcaktohet në bazë së metodologjisë së dhënë në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1359, datë 10.10.2008 "Për përdorimin e manualit teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit".

Metodologjitë e llogaritjes së kostos minimale fiskale, çmimit dhe fitimit minimal fiskal për

efekt të llogaritjes së detyrimeve tatimore në sektorin e ndërtimit, të investimeve private apo publike, të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi do të shërbejnë si metodologji alternative të vlerësimit të parë.”.

3. Në pikën 8.3, paragrafi i fundit me përmbajtjen “Furnizimi i shtypshkrimeve të pullave fiskale nga shtypshkronja e Bankës së Shqipërisë, për Ministrinë e Financave, konsiderohet furnizim i përjashtuar nga TVSH”, shfuqizohet.

4. Në fund të pikës 8.5 “Organizatat jofitimprurëse” shtohen paragrafët me këtë përmbajtje:

Në bazë të nenit 1, paragrafi (b) i ligjit nr.10 003, datë 6.10.2008 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar”, furnizimi i mallrave e shërbimeve nga organizatat jofitimprurëse, të cilat kanë statusin e organizatave jofitimprurëse për përfitim publik dhe që çmimet e mallrave dhe shërbimeve që ato furnizojnë janë dukshëm më të ulëta se çmimet e tregut do të jenë furnizime të përjashtuara, nëse këto OFJ përfitojnë statusin e organizatave jofitimprurëse për përfitim publik.

Statusi i organizatave jofitimprurëse për përfitim publik jepet me autorizim nga Ministri i Financave, sipas kritereve dhe procedurave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave. Në bazë të pikës 6 të këtij vendimi të Këshillit të Ministrave, Ministri i Financave revokon ose pezullon autorizimin në rastet kur:

a) Kur organizata jofitimprurëse kryen furnizime mallrash apo shërbimesh, jo kundrejt pagesës së reduktuar.

b) Kur organizata jofitimprurëse kryen furnizim mallrash apo shërbimesh jo në përputhje me qëllimin për të cilin është krijuar.

c) Kur organizata jofitimprurëse pengon, ose nuk bashkëpunon me organet tatimore dhe doganore gjatë ushtrimit të së drejtës së tyre për kontroll, brenda kufirit të së drejtës që u jep legjislacioni në fuqi.

ç) Nuk respekton dispozitat e kuadrit ligjor fiskal.

d) Në rastet kur një organizatë jofitimprurëse nuk e ka statusin e përfitimit publik,

i) në rastin e përfitimit të shumave të dhuruara, kur donatorët kanë kryer një dhurim që nuk kushtëzon që të përfitojë (furnizohet) në këmbim me asnjë shërbim apo mall nga OFJ-ja, atëherë ky dhurim parash, malli ose shërbimi nuk konsiderohet si një furnizim i tatueshëm dhe nuk aplikohet asnjëra nga shkallët tatimore.

Dhurime të tilla konsiderohen ato që:

a) bazohen në programe apo fonde të dedikuara të donatorit për mbështetjen e zhvillimit të shoqërisë civile, qoftë si mbështetje për fuqizim institucional të një organizate jofitimprurëse, qoftë për kryerjen nga ana e kësaj organizate e aktiviteteve në shërbim të interesave publike në përgjithësi apo grupeve të veçanta shoqërore; dhe

b) dedikimi i fondeve të tilla nga donatorët bazohet në rregullat e brendshme të atij donatori dhe/ose bëhet publik nga vetë donatori paraprakisht dhurimit apo njëkohësisht me të;

c) përfitues të mundshëm të këtyre fondeve janë vetëm organizatat jofitimprurëse.

ii) Nëse, dhurimi kushtëzohet që të furnizohet në këmbim me para, mall ose shërbim të furnizuar nga OJF-ja dhe atëherë ky furnizim i bërë nga donatori është si çdo furnizim tjetër i tatueshëm dhe po ashtu furnizimi i bërë nga OJF-ja në këmbim të vlerës së dhurimit. Dhurime do të konsiderohen të tilla kur nuk plotësojnë kriteret e germës “i” më sipër.

5. Në pikën 9.1, pas sesionit I, shtohet sesioni I/I me këtë përmbajtje:

I/I Skema e shtyrjes së pagesës së TVSH-së, për importimin e makinerive e të pajisjeve, kur cikli i zhvillimit të investimeve dhe fillimi i ofrimit të prodhimit apo shërbimit është mbi 12 muaj.

Bazuar në pikën 2.1 të nenit 26 të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar, për rastet kur cikli i zhvillimit të investimeve dhe fillimit të ofrimit të prodhimit ose të shërbimit është më i gjatë se 12 muaj, Ministri i Financave ka autoritetin ta zgjasë afatin e shtyrjes së pagesës së TVSH-së, në varësi të ciklit të zhvillimit të investimit të parashikuar në marrëveshje apo kontratë. Sipas kësaj skeme, TVSH-ja nuk paguhet në doganë, në çastin e importit.

Skema e re e shtyrjes së pagesës së TVSH-së përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

6. Në pikën 11.1 “Të dhënat që duhet të përmbajë një faturë tatimore”, pas paragrafit të pestë shtohet fjalia me këtë përmbajtje.

“Faturat tatimore të energjisë elektrike të OSSH-së, në tremujorin e parë të vitit fiskal duhet të kenë në fund, nën një zë më vete, tarifën e shërbimit për përdorimin e aparateve televizive. Vjelja e kësaj tarife bëhet sipas udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Financave me Radiotelevizionin Shqiptar.”.

7. Në pikën 15 “Shitja me pakicë”, shifra “10 000 lekë” bëhet “20 000 lekë”.

8. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
**Ridvan Bode**

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare,** në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 14.1.2009
Doli nga shtypi më 15.1.2009

| | |
|---|---|
| Tirazhi: 3300 copë | Formati: 61x86/8 |

Shtypshkronja ADEL PRINT
Tiranë, 2009

Çmimi 40 lekë